



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.08

Prishtinë, më 19.1.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Munguan:** Nezir Çoçaj, Abdyli Salihu dhe Verica Qeraniq.

**Të ftuar:** Arton Demhasaj-ÇOHU, Rron Gjinovci-ORCA, Rinor Qehaja-EDGUARD, Rasim Alija-D4D dhe Kushtrim Bajrami-KEC.

**Përfaqësues të tjerë:** Gramas Buçinca-ORCA, Albana Bjrami-RTK/Radio, Gordana Sobotiq.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me Koalicionin e OJQ-së për Integritet dhe Transparencë në Universitet;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

## **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **2. Takim me Koalicinin e OJQ-së për Integritet dhe Transparencë në Universitet;**

**Ismail Kurteshi**, kryetar, në fillim të mbledhjes tha se takimi me organizatat e shoqërisë civile pjesë të koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet, është realizuar me qëllim të marrjes së informacioneve dhe sugjerimeve për të ndikuar pozitivisht në zgjidhjen e problemeve në arsimin e lartë. Fjala iu dha përfaqësuesve të ftuar që të paraqesin të gjeturat rreth gjendjes në Universitet.

**Arton Demhasaj-ÇOHU**, tha se organizata që ai e përfaqëson, ka trajtuar çështjen e politizimit të stafit akademik në Universitetin e Prishtinës, çështjen e shitblerjes së temave të diplomave, të cilën çështje e kemi dëshmuar me video e dokumente tjera, mungesën e literaturës për lëndët bazike si dhe vlerësimin e dobët të studentëve. Ai tha se ekzistojnë dy lloje të profesorëve në UP; një lloj i profesorëve që e kanë përdor politikën për të hyrë në universitet dhe lloji tjetër të cilët e kanë përdor universitetin për të hyrë në politikë, andaj lidhur me këtë, miratimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit do të ishte mirëseardhur për të parandaluar këto dukuri.

**Rinor Qehaja-EDGUARD**, tha se koalicioni i organizatave të shoqërisë civile është themeluar në prill të vitit të kaluar. Fillimisht jemi marrë me hulumtim dhe avokim në UP dhe nga ky vit kemi vendosur që të realizojmë hulumtime edhe në kolegjet private. Instituti Edguard ka realizuar dy hulumtime që kanë pasur për qëllim matjen e perceptimit të studentëve për gjendjen në Universitetin e Prishtinës dhe të dhënat na kanë treguar për një gjendje jo të mirë, ndërsa hulumtimi i dytë ka të bëjë me nivelin e plagjiaturës në punimet e profesorëve dhe këtu kemi të gjetura shqetësuese për nivelin e plagjiaturës në punimet e profesorëve.

**Rron Gjnovci-ORCA**, tha se ORCA ka realizuar një hulumtim rreth integritetit akademik në UP, ka bërë analizën e CV-ve të profesorëve që kanë tituj akademik dhe nga ky hulumtim është konstatuar se 28 % apo 137 profesorë kanë publikuar së paku një herë në revista të dyshimta, 72% e profesorëve që kanë tituj nuk i justifikojnë titujt që i mbajnë, kanë më pak punime sesa duhet të kenë, edhe pse nuk kanë ndryshuar rregullat asnjëherë. Nga hulumtimi ynë del se në çdo fakultet më shumë se gjysma e profesorëve nuk i justifikojnë titujt që mbajnë. Gjatë hulumtimit është vërejtur se Fakulteti i Bujqësisë, Mjekësisë dhe i Shkencave Natyrore, prijnë me numër të publikimeve shkencore, ndërsa Fakulteti i Edukimit i afrohet mesatares së universitetit. Problemi më i madh është se 122 profesorë kanë thirrjen me të lartë të profesorit të rregullt, kanë kontratë të përhershme dhe nuk i justifikojnë titujt e tyre akademik.

Ai tha se lidhur me tejkalimin e problemeve, sa i përket publikimeve shkencore, kemi biseduar me ministrin e MASHT-it, me të cilin bashkëpunimi është në nivelin e duhur dhe shumë shpejt pritet të nxirret udhëzimin administrativ për publikime në revista shkencore.

Në vijim përmendi edhe çështjen e kallëzimit penal për një profesor në Fakultetin Filozofik dhe çështjen e akreditimit të disa programeve nga fusha e mjekësisë.

**Rasim Alija-D4D**, paraqiti para anëtarëve të Komisionit hulumtimin e që ka bërë D4D, në lidhje me punën e Këshillit Drejtues të UP-së, i cili kryesisht është fokusuar në kompetencat dhe transparencën e këtij Këshilli që sipas hulumtimit është vërejtur mungesë transparencës në publikimin e vendimeve të Këshillit Drejtues, jotransparenca gjatë mbledhjeve të Këshillit dhe

mosrespektim të afateve për njoftimin e anëtarëve të Këshillit për mbajtjen e mbledhjeve. Emërimet në këtë Këshill janë kryesisht politike dhe mospublikim të CV-ve të anëtarëve të Këshillit. Ne këtë rast është konstatuar se mungon një rregullore që përcakton qartazi pjesën e transparencës dhe llogaridhënien e punës së Këshillit Drejtues të universitetit.

**Kushtrim Bajrami-KEC**, tha se organizata jonë nuk ka realizuar ndonjë hulumtim konkret rreth UP-së, por ka mbështetur organizatat tjera në realizimin e hulumtimeve. Ai ngriti nevojën e miratimit të Ligjit për Arsimin e Lartë, çështjen e shkarkimeve të bordeve pa dhënë arsyetimet për shkarkimet e tyre, me theks të veçantë shkarkimi i Bordit të Agjencisë së Akreditimit. Ai tha se ky shkarkim ndikon drejtpërdrejt në punën e punën e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë.

Problem tjetër veçoi moszbatimin e Ligjit për Profesionet e Rregulluara, ndërsa sa i përket avancimeve akademike në UP, tha se e ndan mendimin e tij me organizatat tjera.

**Ismajl Kurteshi**, tha se me qëllim të përmirësimit të gjendjes në arsimin e lartë, me të drejtë u ngrit çështja e miratimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili projektligj para dy vitesh është tërhequr nga procedura e shqyrtimit në Kuvend pa ndonjë arsytim.

Kurteshi e vlerësoi iniciativën e organizatave të shoqërisë civile për mbikëqyrjen e punës edhe të kolegjeve private për të parë dobësitë e tyre. Lidhur me sugjerimin e organizatave të shoqërisë civile për të formuar një komision hetimor, ai tha se një gjë e tillë do të ndodhë dhe së shpejti Komisioni do të vizitojë rektorin e UP-së dhe rektorët e Universiteteve tjera publike. Gjithashtu ceku shqetësimin për mënyrën e shkarkimit të bordeve të ndryshme, me theks të veçantë Bordin e Agjencisë së Akreditimit.

Një çështje që organizatat e shoqërisë civile nuk janë marrë ka të bëjë me tekstet mësimore që vijnë nga Serbia me përmbajtje antikushtetuese, në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, fjala vjen tekstet e gjeografisë Kosovën e shpjegojnë si pjesë të Serbisë, në tekstet e historisë që kanë cilësime të ndryshme për shqiptarët dhe për UÇK-në dhe gjëra të tjera, derisa ekziston një marrëveshje që edhe tekstet shqip të shkojnë në Luginë të Preshevës dhe në atë marrëveshje parashihet formimi i një Komisioni për vlerësimin e teksteve që vijnë nga Serbia. Ky komision ekziston, dhe ka bërë njëherë një vlerësim të teksteve dhe ka konstatuar se përmbajtja e tyre është antikushtetuese, por nuk është marr askush me të gjeturat e këtij komisioni.

**Teuta Haxhiu**, në diskutimin e saj tha se ky takim është me interes të veçantë, duke pasur parash se gjendja në arsimin e lartë nuk është e mirë. Një gjë e tillë është konstatuar edhe gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Arsimin e Lartë, në cilësinë e kryesueses së grupit punues dhe shumica e të gjeturave gjatë monitorimit kanë të bëjnë me shqetësimet e ngritura.

Sa i përket çështjes së miratimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Haxhiu tha se miratimi i tij do të shërbente për përmirësimin e gjendjes në arsimin e lartë dhe në këtë drejtim kjo duhet të fillojë që nga deputet, për shkak se është e pamundur të jepet kontributi i një personi në disa vende të punës.

Sa i përket formimit të Komisionit Hetimor, i cili nga parafolësit, u tha se disa herë ka kërkuar formimin e një komisioni profesional jopolitik, i cili do të merrej me matjen e performancës së kolegjeve private si dhe universiteteve publike.

Në vazhdim tha se përkrah konkurrencën për kolegje private, mirëpo, njëkohësisht duhet të kenë cilësi sikurse që ndodh në vendet e tjera.

Sa i përket projektligjit për Arsimin e Lartë, tha se nuk e kupton arsyen e vonësës së tij për ta proceduar në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Problem tjetër theksoi edhe vendimin e ministrit për sa i përket çështjes për përgatitje të mësimdhënësve në disa programe të kolegjeve private, e cila është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 5, të Ligjit për Arsimin e Lartë.

**Adem Mikullovc**i, tha se shqetësimet që u shfaqen kanë qenë të njohura për ne, por jo në masën që u prezantuan. Ai u pajtua me çështjen e ngritur rreth formimit të Komisionit Hetimor për UP-në si dhe çështjen e përzgjedhjes së personave joprofesionalë dhe joadekuatë në borde të caktuara, duke pasur parasysh mënyrën e zgjedhjes së tyre, andaj propozoi që zgjedhja e anëtarëve në këto borde e këshilla të bëhet nga të punësuarit në atë organ.

**Arbërie Nagavci**, përmendi shqetësimin e saj në lidhje me shkarkimin e anëtarëve të bordit të Agjencisë së Akreditimit dhe mosgatishmërinë e Qeverisë për të raportuar në Kuvend lidhur me arsyet e shkarkimit të tyre dhe për këtë ka bërë pyetje parlamentare. Çështje tjetër të cilën e ngriti ishte adresimi i rekomandimeve të dala nga hulumtimet e organizatave të shoqërisë civile në UP dhe sa janë marr parasysh këto rekomandime apo të gjetura.

**Albulena Balaj-Halimaj**, në diskutimin e saj tha se mirëpret bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe kërkoi nga ato që idetë dhe sugjerimet e tyre ti bartin edhe në MASHT. Shqetësimet e ngritura rreth politizimit të UP-së, blerjes së diplomave, plagjiaturat, punimet shkencore, autonomia e UP-së, shkarkimi i bordeve që mendoj se janë dhënë arsyet e nevojshme, emërimi i personave të njëjtë në disa borde apo komisione të ndryshme, vonesa në nostrifikim të diplomave me vite të tëra dhe çështje të tjera që u ngritën vërtetë kërkojnë një përkushtim dhe bashkëpunim të gjithëve për përmirësim të gjendjes.

Në vijim përmendi edhe çështjen e Fakultetit të Edukimit, që duhet ta ketë një fokus më të madh për shkak se nga aty dalin ide dhe kuadro të reja.

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, tha se një takim i tillë është një hap i mirë i bashkëbisedimit me organizatat e shoqërisë civile që do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë apo mbarëvajtjen e arsimit në Kosovë. Përkrahu idenë që Projektligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Projektligji për Arsimin e Lartë të procedohen në Kuvend për shqyrtim dhe miratim si dhe mbështeti idenë për formimin e një komisioni profesional hetimor.

Sa i përket shkarkimit të Bordit të Agjencisë së Akreditimit, tha se nuk pajtohet me procedurën dhe mënyrën e shkarkimit ngase paraprakisht është dashur të kërkohet llogari për punën e tyre.

**Ismajl Kurteshi**, theksoi se një çështje që mbeti pa u diskutuar, ka të bëjë me regjistrimin e studentëve, në çfarëdo kohe në kolegjet private, ende vazhdohet me reklama ku bëhet thirrje për regjistrim, duke pasur parasysh se me këtë ata shkelin ligjin, andaj kërkoj që edhe kjo çështje të trajtohet nga organizatat e shoqërisë civile.

Në fund të diskutimit, falënderoj të pranishmit për prezantimet e të gjeturave nga hulumtimet e tyre dhe shprehu gatishmërinë e Komisionit për të vazhduar bashkëpunimin.

### **3. Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

***E përgatiti:***  
***Stafi mbështetës i Komisionit.***

Kryetari i Komisionit,  
Ismajl Kurteshi